

Prof. dr. Lush Culaj

GJENEZA HISTORIKE E FAMILJES TË ANTON ÇETËS

Fani si krahinë, shtrirja dhe përbërja e tij

Dëshmitë arkeologjike të kulturës së mesjetës së hershme tregojnë se në Mirditë kishte shumë vendbanime dhe varreza të mëdha. Këto të dhëna janë një pasqyrë e qartë e zhvillimit dhe trashëgimisë së pasur kulturore të kësaj krahine¹. Po natyrisht, brenda këtij kuadri ka pasur edhe lëvizje migruese të kësaj popullsie dhe lëvizje të shpeshta².

Mirdita është një bashkësi e gjerë krahinore e dallueshme nga simotrat e saj fqinje, jo vetëm nga emri, nga shtrirja gjeografike, nga ndërgjegjja e përkatësisë së banorëve të saj, por edhe nga mëvetësia e dukurive në etnokulturën e saj. Kompleksi i traditave e dokeve, po kështu edhe ngjyrimet në elementë të veçantë kulturorë dallojnë si të mëvetësishëm për Mirditën, që i japin asaj një identitet kulturor, duke i marrë ata në tërësinë e tyre të dallueshme³.

Në aspektin fiziko-gjeografik, Fani si njësi etno-kulturore përfaqëson njërin nga 12 bajraqet e Mirditës dhe zë pjesën më të madhe të pellgut ujëmbledhës të Fanit të Vogël, në gjysmën veriore të tij. Një vend që shtrihet në të dy anët e luginës, e cila ndodhet mes Malit të Zepës në Lindje e malit tjetër të lartë të Munellës në Perëndim. Në pjesën veriore krahina nuk e ka të vështirë të lidhet me pellgun ujëmbledhës të Drinit dhe përkatësisht me njësinë etnokulturore të Lumës, të Hasit dhe më gjerë. Këtë lehtësi e krijon ekzistenca e Qafë Kumbullës dhe e Qafës së Komit pranë malit në Thirrë. Është një zonë kodrinoro-malore që fillon nga shpatet e maleve që përmendem, duke zbritur gradualisht deri në pjesën e poshtme pranë lumit Fan me një reliev të butë (taracë lumore), që është krijuar, ndër të tjera, edhe nga veprimtaria lumore⁴.

Mirdita kufizohet me gjashtë rrethe. Në pjesën veriore kufizohet me rrethin e Pukës, në verilindje me rrethin e Kukësit, në lindje me rrethin e

1 Gjon Marku, Nderfana, monografi, Tiranë, 2008 f. 19.

2 Prof. dr. Mark Tirta, Mirdita e moçme - migrime të popullsisë së saj, punim nga Konferenca Shkencore e mbajtur në Rrëshen më 10 tetor 2001 i përmbledhur në librin Mirdita në histori dhe etno-kulturë, shtëpia botuese Mirdita, 2001, f. 14.

3 Bardhok Pulaj, Mirdita njohuri për vendlindjen II Mirdita 2002, f. 7.

4 Gjet Ndoj, Antologji historike, themele të ruajtura të një shtëpie evropiane të shembur, Tiranë, 2009, f. 307.

Dibrës, në perëndim me rrethin e Lezhës, në jug dhe juglindje me rrethin e Matit dhe në jugperëndim me rrethin e Kurbinit⁵.

Shikuar nga aspekti etno-kulturor, Fani është pjesë e Mirditës (Bajraku i katërt), duke zënë pjesën më veriore të saj dhe duke u kufizuar me tej me krahinën e Lumës e më në veriperëndim me “7 bajraqet e Pukës”. Në kuptimin e përkatësisë rezulton se emigrimi i popullsisë nga Rrafshi i Dukagjinit në Fan dhe nga Fani në Gjakovë, Pejë, Klinë, Deçan etj. ka qenë një fenomen shumë i zakonshëm që Edit⁷h Durham, u habit nga vazhdimësia dhe përmasat e këtij fenomeni dhe konkludoi se gjithmonë sipas saj - “Pa dyshim mëmëdheu i mirditorëve është Pashtriku i Gjakovës dhe fushat përreth”. Në fakt këto lëvizje kanë prekur të 5 bajraqet e Mirditës, por veçanërisht krahinën e Fanit. Këtij argumenti i vjen në ndihmë fakti se edhe sot ka me qindra e me shumë raste, ku mund të evidentohen familje në Kosovë që e quajnë veten mirditas, bile fanë, ndërsa në të gjitha familjet e fiset e Fanit e kanë një lidhje me vende, prona (toka) apo fise të ndryshme në Rrafshin e Dukagjinit etj.⁶

Më 18 qershor 1878 i dërguan Kongresit të Berlinit kërkesën për të njohur një principatë të Shqipërisë së Veriut, krerët e Mirditës, Kthellës, Malësisë së Lezhës, Pukës dhe Lurës ku kryetar të ishte Preng Bib Doda. Kongresi i Berlinit njohu autonominë e Mirditës në bazë të përkrahjes që i dhanë kësaj ideje Franca dhe Austro-Hungaria⁷. Megjithatë, mirditorët nuk ishin të kënaqur pa e shijuar lirinë të plotë. Ata bënë sulme të befasishme kundër reparteve ushtarake turke. Hakmerreshin kundër pushtuesit për dhunën e ushtruar ndaj tyre⁸. Kreu i çdo fisi, sipas Edit Durhamit, është flamurbajtës i trashëguar, bajraktar. Fiset kanë një flamur turk dhe vetëm në Mirditë kanë një flamur të veçantë me një diell me rreze mbi të⁹. Edhe kjo është një dëshmi për mospërfilljen dhe rezistencën shekullore të mirditorëve kundër pushtuesit turk.

Fiset shqiptare janë histori e pashkruar e popullit shqiptar me zanafillë nga ilirët, si njomza të fundit të një druri vigan të lidhur me një të parë të fisit¹⁰.

Ndërkaq, profesor Mark Krasniqi mendon se fiset janë organizata me kompaktësi të madhe, me shpirt luftarak, për të mbrojtur lirinë, traditën, pronat e kullosat nga çdo sulm i jashtëm¹¹.

5 Ndue Gega, Mirdita gjeografike, shtëpia botuese Mirdita, 2006, f. 7.

6 Gjet Ndoj, Antologji historike, vep. cit f. 308.

7 Ndue Gega, po aty, f. 21.

8 Dr. Pal Doçi- Mirdita, vatër e qëndresës antiosmane - vështrim etnologjik e historik 1479-1912, shtëpia botuese Mirdita, Tiranë, 1999, f. 141.

9 Edith Durham, Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera, Tiranë, 1991, f. 113-114.

10 Eqrem Çabej, Studime gjuhësore, vëllimi V, Prishtinë, 1978, f. 351.

11 Mark Krasniqi, Nga gurma e traditës, Prishtinë, 1991, f. 134.

Teza mbi ardhjen e popullit nga Mirdita në Kosovë do të jetë favorizuese për qarqet ekstremiste dhe pseudo-shkencore serbe, duke mbrojtur qëndrimin se trojet shqiptare në Kosovë e në viset tjera të ish-Jugosllavisë paskan qenë vise të banuara nga sllavët dhe më pas duke i dëbuar ata u popullzuan me shqiptarë ose se aty paska pasur popullsi sllave të shqiptarizuar. Po qe se serbet mendojnë se Kosova është "zemra" dhe "djepi" i shtetit serb, duhet të kuptojnë se "transplantimi" është bërë në trup të huaj, sikurse edhe fëmija që përkundet në djep është fëmijë i huaj¹². Këto teza antishkencore i demanton studiuesi mirditor dr. sc. Mark Tirta në punimin e tij shkencor "Dëshmi migrimesh në shekullin XV-XV nga Kosova në Mirditë", ku përmes argumenteve shkencore, paraqet lëvizjet e popullsisë shqiptare nga Kosova në Mirditë dhe rikthimin e tyre në Kosovë. Pra, ata nuk e popullzuan Kosovën me shqiptarë, por u rikthyen në trevat e veta. Migrimet e tilla janë të njohura gjatë historisë dhe ato janë më se normale.

Mirdita ishte ndarë në pesë bajraqe. Bajraku ishte njësi administrative me funksione ushtarake e pleqnare (gjyqësore) në thelb në të cilat qëndronte organizimi i vjetër shoqëror. Brenda bajrakut në përgjithësi mbeti e paprekur struktura e shoqërisë së lirë malësore dhe mbijetuan institucionet më karakteristike të saj.

Krahina e Mirditës në Vilajetin e Shkodrës, sipas të dhënave zyrtare të vitit 1892:

Bajraku i Oroshit
 Bajraku i Fandit
 Bajraku i Spaçit
 Bajraku i Kushnenit
 Bajraku i Dibrrit¹³.

Xhuxha-vendlindja e gjyshit të Anton Çetës

Xhuxha është fshat nga më të hershmit i populluar. Konsiderohet se "banorët e mëvonshëm që kanë ardhur në fshatin Xhuxhë janë me prejardhje nga fisi Xhuxholli i rrethit të Pejës. Ata u vendosën në Kodër-Xhuxhë. Konsiderohet se kur këta kanë arritur dhe janë vendosur në këtë vend kanë gjetur të vendosur në këtë vendbanim familjen Çeta që nuk dihet se nga ka ardhur, por flitet se është familja më e vjetër në Fan"¹⁴.

Natyrisht që familja Çeta i përket Bajrakut të Fanit.

¹² Esat Stavilevci, Në mbrojtje të pavarësisë të Kosovës, Prishtinë, 1998, f. 189.

¹³ Kahreman Ulqini, Bajraku në organizimin e vjetër shoqëror, fundi i shek. XVIII deri më 1912, Tiranë, 1991, f. 22.

¹⁴ Gjet Ndoj, vep. cit. f. 309.

Përveç këtyre fiseve janë këto fise e barqe kryesore: Dedaj, Micaj, Gjonaj, Gjinaj, Mena, Karaci, Vocaj, Kocaj, Buci etj.¹⁵

Prof. Mark Tirta, duke folur për familjen e tij Tirtajt e Oroshit, shpjegon se ata janë dy degësh njëra vendase e tjetra e ardhur nga Fandi (Shëngjin), si nip bije e mbështetur në degën e parë. Ai dëshmon që janë farefis i Çetajve të Fandit. “Në vendbanimin e ri ruhen toponimet e emrit të vjetër që e patën kur erdhën si: Kodra e Çetës. Laku i Çetës, Proska e Çetës etj.”¹⁶

Ka indikacione sipas të cilave familja Çeta kohë më parë të ketë qenë quajtur “Hala”, emër që ekziston edhe sot, ndoshta si i rikthyer dhjetëra vjet më parë, diku pas Luftës së Dytë¹⁷. Sipas gojëdhënës dhe disa dëshmime thuhet se në vitin 1862, kur në Mirditë kishte kryengritje që udhëhiqej nga princi i saj Bibë Doda, pas saj turqit bënë reprezalje në shenjë hakmarrjeje kundër mirditasve. Gjatë përlëshjeve të përgjakshme me burrat dhe djemtë e Kodër Xhuxhës u vra-në shumë turq. Me t’u kthyer trupat në Shkodër i raportuan Valiut se kishin zhvilluar një betejë me një çetë kryengritësish në Fanë. Në fakt thuhet se ata burra e djem ishin të gjithë të një familje të madhe, por nuk ishte një çetë siç e kishin pandehur turqit. Që nga ajo kohë ajo shtëpi (familje), e mori emrin familja “Çeta”¹⁸.

Mark Çeta

Po kush ishte gjyshi i Anton Çetës?

Pa dyshim se ishte një nga burrat më me zë të kësaj familjeje të dëgjuar atdhetare.

Mark Çeta kishte lindur në vitin 1860, në Xhuxhë të Fanit. Ai u rrit dhe u edukua me frymën atdhetare dhe me urrejtjen kundër pushtuesit turk që me pushtimin e egër vazhdonte ta ngufaste Mirditën dhe gjitha territoret shqiptare. Kur u rrit Marku binte në sy si një djalë trim, i shkathët dhe me një autoritet të madh në krahinë.

Në vitin 1884, në moshën 24-vjeçare, Marku largohet nga vendlindja dhe vendoset në Prizren, duke punuar si adjutant i konsullit austriak në Prizren¹⁹. Pikërisht në Prizren, pas një periudhe të shkurtër kohore, ai martohet me Gjysten, bijën e një familje të njohur të Prizrenit.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Prof. dr. Mark Tirta. Mirdita e moçme e migrime të popullsisë së saj, pun. cit. f. 23.

¹⁷ Kjo dëshkohet nga e dhëna se sot në fshatin Rrile të Lezhës jeton familja Hala të cilët janë kushërinj të afërm të familjes të Anton Çetës. Intervistë e autorit e zhvilluar më datën 13. VI. 2010 me Gjon Gjetë Ndue Halen i lindur më 1939 në fshatin Xhuxhë – kushëri i afërt i prof. Anton Çetës i cili tash jeton në fshatin Rrilë- Lezhë.

¹⁸ Gjet Ndoj, vep. cit. f. 309.

¹⁹ Po aty . f. 310.

Nga martesë e tyre Marku dhe Gjystja kishin pesë fëmijë, përkatësisht dy djem e tre vajza. Djali i parë ishte Kola, ndërsa i dyti Lazri (i ati i Anton Çettës).

Gjatë katërbëdhjetë viteve sa ka punuar në Konsullatën e Austrisë në Prizren, gjegejësish gjë në vitin 1898, Mark Çeta nuk pushoi asnjëherë veprimtarinë atdhetare duke i dalë zot popullit shqiptar të Kosovës në format më të ndryshme. Ai me tërë qenien e tij përpiquej ta pasqyronte sa më fuqishëm dhunën dhe terrorin e pushtetit turk mbi shqiptarët, por edhe luftën për autonominë e shqiptarëve nga Turqia²⁰.

Interesimi i Austro-Hungarisë për shqiptarët përcaktohej nga arsye gjeografike dhe politike. Me gjithë synimet për mbikëqyrje të plotë mbi shqiptarët, Qeveria austro-hungareze, nga ana e tjetër nxiste aspiratat për autonomi të shqiptarëve dhe inkurajonte pa kursyer mjete dhe ndihma ata njerëz që do të ishin mirënjohës ndaj mbështetjes së saj e do t'i qëndronin besnikë politikës austro-hungareze²¹. Politika e Vjenës gjithashtu mendonte që ishte detyrë e tyre të zhvillonte lidhjet me udhëheqësit e lëvizjes kombëtare shqiptare dhe të ndihmonte në çdo mënyrë zhvillimin intelektual si dhe mirëqenien materiale të popullit shqiptar²². Pikërisht mbi këtë bazë ishte edhe kontributi i Mark Çetës për çështjen kombëtare.

Pra, gjatë viteve 1884-1898, ai dallohej për veprimtari bashkëpunuese me austriakët, sidomos kur bëhej fjalë për çështje që lidheshin me interesat e lëvizjes dhe të kombit shqiptar. U lidh shumë shpejt me eksponentë të Lëvizjes tonë për liri kombëtare.

Pas vitit 1898 Mark Çeta u transferua me detyrë nga konsullata austro-hungareze e Prizrenit në atë të Selanikut. Aty qëndroi për pesë vjet, përkatësisht deri në vitin 1903. Ai me familje ka punuar e jetuar në Selanik, po në Konsulla-tën austriake atje.

Aktiviteti i Mark Çetës ka qenë interesant dhe gjatë kohës së shërbimit të tij në Konsullatën Austriake në Selanik. Në Selanik ai do të shfrytëzonte rastin që t'i shkollonte edhe dy djemtë e tij Kolën dhe Lazrin, pranë Liceut Francez²³.

Në këtë vit e në vazhdim, Marku njihet dhe bashkëpunon me patriotë dhe figura të rendit të parë të kombit shqiptar. Kështu, më 1898 Marku njihet me Shahin Kolonjën, një nga veprimtarët më të shquar të lëvizjes kulturore e patriotike shqiptare. Shahin Kolonja ishte botuesi i njëres ndër gazetatat më të njohura shqiptare në Sofje, e cila ndikoi mjaft në frymëzimin e Mark Çetës për përgatitjen e lëvizjes për pavarësi nga Turqia. Gjatë

20 Po aty.

21 Lush Culaj, *Në udhëkryqet e historisë shqiptare*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2009, f. 42-43.

22 Stavro Skendi, *Zgjidhimi kombëtar shqiptar 1878-1912*, Tiranë, 2000, f. 244-245.

23 Gjet Ndoj, *vep. cit. f. 311*.

aktivitetit patriotik të vazhdueshëm ai arriti të kishte letërkëmbim me Aladro Kastriotin nga Italia e Jugut, i cili punonte për Lëvizjen Nacionaliste Shqiptare. Në vitin 1902 me anë të z. Visko Babatasit, Aladro Kastrioti i dërgoi për Mark Çetën flamurët e parë shqiptarë si dhe dokumente që bënin fjalë për parinë shqiptare, e cila duhej të shpallte kryengritjen kundër Turqisë, në dy vilajete shqiptare: të Kosovës dhe atë të Shkodrës. Këtë e dëshmon edhe shtypi i kohës: "Mark Çeta në rrezik të jetës se vet e tue sakrifikue grue e fëmij, vajti në Nish (Serbi) muer në dorëzim flamur e dokumenta, e si trim e besnik që ish, nuk u tremb aspak nga spiunet e regjimit të Sulltan Hamidit, por i suell në Shqipni, msheftas e i shpërndau"²⁴.

Veprimtarinë patriotike të Mark Çetës e njohu dhe e vlerësoi Princi Albert Gjika, i cili kryesonte Komitetin Nacionalist Shqiptar në Rumani, Faik Konica - botuesi i revistës Albania etj.

Ishte periudha kohore kur shqiptarët ishin të ndarë në dy parti sado që në programin e tyre kishin pavarësinë e Shqipërisë: Anëtarët e Aladro Kastriotit dhe anëtarët e Princ Albert Gjikës. Për Mark Çetën nuk kishte rëndësi se kush do të merrte kurorën e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, ngase e rëndësishme ishte liria e Shqipërisë. "Por tue dhanun një shembull të çuditshëm karakteri e disipline atyre qe e pyetshin se për cilin kandidat e dëshironte fronin e Skënderbeut, Mark Çeta përgjigjej "dishiri i jem asht qi të lirohet Shqipnia, pa sa për fron të saj e din vet ajo se cilit ka me ja dhanë"²⁵.

Në kryengritjet e viteve 1910-1912, kryengritje të cilat i paraprinë Pavarësisë së Shqipërisë në luftë kundër Perandorisë Osmane dhe fqinjëve grabitqarë, Mark Çeta ka qenë mjaft aktiv. Veprimtaria e tij në këtë kohë përqendrohet në pjesëmarrjen dhe organizimin e kryengritjes së vitit 1910 në Kosovë²⁶. Këto kryengritje dhe sakrifica e shqiptarëve sollën shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë me mbështetjen kryesore të Austro-Hungarisë²⁷.

Megjithatë, me shpalljen e pavarësisë nuk u zgjidh çështja e çlirimit dhe e bashkimit kombëtar të të gjitha trevave shqiptare, formimi i shtetit të pavarur përbën ngjarjen më të rëndësishme në historinë e kombit shqiptar gjatë këtij shekulli²⁸. Fillimi i dhjetorit të vitit 1912 i gjen tërë Kosovën, Shqipërinë Veriore, Lindore dhe të Mesme, deri të lumi Shkumbin të pushtuara nga ushtritë serbe e malazeze. Vetëm Shkodra vazhonte rezistencën, por gjendej e rrethuar. Në jug trupat greke kishin rrethuar Janinën, kishin pushtuar Çamërinë dhe po vërshonin drejt viseve të tjera të

24 Gjet Ndoj, vep. cit. f. 311, mbështetur në gazetën Shekulli i ri i datës 26 tetor 1928.

25 Po aty.

26 Po aty, f. 312.

27 Lush Culaj, Shqiptarët në gjysmën e parë të shekullit XX, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2005, Kontributi austro-hun-ga-rez në themelimin e shtetit shqiptar, f. 118-125, Prishtinë, 2005.

28 Kosova në vështrim enciklopedik, Botimet Toena, Tiranë, 1999, f. 106.

Shqipërisë së Jugut²⁹. Edhe në këtë periudhë kohore, por edhe në vijimësi aktiviteti kombëtar i Mark Çetës ishte i vazh-dueshëm.

Merr pjesë përkrah forcave qeveritare shqiptare në luftën kundër kryengritjes antishqiptare-sulltaniste, të udhëhequr nga Haxhi Qamili, në vitin 1914.

Urrente dhe vepronte edhe kundër forcave esadiste. Mark Çetën do ta gjejmë edhe si pjesëmarrës në luftimet që bëjnë shqiptarët kundër pushtimit sllavo-malazez të Shkodrës.

Ky aktivitet i madh patriotik e bëri shumë të njohur Mark Çetën në rrethet patriotike të kohës. Përveç kësaj, ky angazhim, jo vetëm e bëri të njohur, por edhe e rreshtoi atë duke bashkëpunuar me personalitete të tjera madhore kom-bëtare si: Ismail Qemalin, Nikollë Kaçorrin, Shahin Kolonjën, Murat Toptanin, Abdyl Ypin, Dervish Himën, Hilë Mosin, Faik Konicën, Mati Logoreci, Mithat Frashërin, Kristo Luarasin, Mihal Gramenon etj.

Mark Çeta vdiq pas një sëmundje të rëndë, më 13 tetor të vitit 1928, në Tiranë. Të gjitha këto përpjekje atdhetare nuk i sollën asnjë dobi materiale këtij patrioti të vyeshëm. Në fakt edhe veprimtaria e tij nuk e kishte këtë synim. Ai nuk tentoi kurrë të pasurohej në dëm të popullit të vet të shumëvujtur. Në moshën 65 vjeçe, i plakur e i lodhur, për të mos iu rënduar kujt e për ta fituar me nderë bukën e vet, po punonte për shërimin e sëmundjes së lisë në qytete e në katunde, në fusha e në male, ku u sëmur rëndë e prej së cilës sëmundje edhe vdiq. Pra, edhe vdekja e gjeti duke i shërbyer atdheut të vet deri në minutën e fundit.

Kështu, Mark Çeta e kreu misionin e vet patriotik tue duke lenë mbas vedit namin e një shqiptari të vërtetë, një malësori kreshnik³⁰.

Vdekja e patriotit Mark Çeta pati një jehonë të madhe. Dhimbja për vdekjen e tij u pasqyrua dhe në shtypin e kohës. Në Arkivin e Shtetit Shqiptar ne veçuan artikullin e Gazetës Shekulli i ri, e dt. 26 tetor 1928, me titull: "Ushtari i idhesë, patrioti i dëgjuar- Mark Çeta vdiq"³¹.

Në këtë artikull pasqyrohet përmbledhtazi, jo vetëm jehona e vdekjes dhe humbja e patriotit, por dhe momente mjaft interesante nga veprimtaria e tij patriotike.

Ky artikull përfundon me nderimin edhe ndaj dy djemve të tij dhe ruajtjen e kujtimit të përjetshëm jo vetëm ndaj një prindi të tillë, por edhe ndaj një atdhetari të çmuar. "Dy djemve të tij të paharrueshëm i heqim kapelën tonë e i thomi fjalët e Poetit tonë Kombëtar: Letë i qoftë mbi vorr ledina, akulli, bora e serotina"³².

²⁹ Historia e popullit shqiptar për shkolla të mesme, Rilindja, Prishtinë, redaktor Hysni Myzyri pa vit botimi, f. 133-135.

³⁰ Gjet Ndoj, vep. cit. f. 313.

³¹ Gjet Ndoj, vep. cit. f. 312.

³² AQSH, gazeta "Shekulli i ri", 26 tetor 1928.

Lazër Çetta

Falë përkushtimit të babait Mark Çetës fëmijët e tij qenë të edukuar dhe të arsimuar shumë mirë. U shkolluan edhe në kolegje franceze. Megjithatë, më i përparuari jo vetëm në fushën e dijes, por edhe në fusha të tjera, ndër fëmijët e Mark Çetës ka qenë Lazër Çeta. Ai lindi në Mirëditë, më 1 shkurt të vitit 1895.

Kjo na rezulton edhe në një kopje të pasaportës së tij, që e posedonte i biri i tij, Beniamini në Durrës. Arsimin fillor (5-vjeçar) Lazri e kreu në Prizren në vitin 1908. Arsimin e mesëm e nisi në Shkup (gjimnazin e ulët) dhe më vonë përfundoi College des Freres të Selanikut në vitin 1912³³.

Roli i familjes në edukim patriotik dhe intelektual të Lazër Çetës, por edhe arsimin e tij në shkollat e kolegjet më të mira të kohës, përbëjnë një premisë shumë përcaktuese për një aktivitet të shquar intelektual dhe atdhetar të Lazër Çetës.

Në periudhën e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 1912, Lazri si 17-vjeçar kishte filluar të burrërohej dhe i rrinte përkrah të atit duke i ndihmuar në punët dhe aktivitetet në dobi të atdheut. Atij tashmë, pasi e kishte mbaruar edhe kolegjin, nuk i mungonte jo vetëm guximi dhe vulll rinor, por as arsimimi dhe dija të cilat i vuri pa ngurrim në shërbim të atdheut.

Lazër Çeta u martua në vitin 1917 me Agen nga Gjakova, njohje kjo e bërë në kohën kur Lazri ishte sekretar i Komandës së xhandarmërisë në Gjakovë. Fatkeqësisht bashkëshortja e tij Ageja vdiq e re, por la dy fëmijë, Antonin dhe një vajzë. Në vitin 1936 i detyruar nga rrethanat martesore për së dyti, me një bijë të familjes të Vlashajve nga Durrësi, Katrinën, me të cilën kishte një djalë, Beniaminin në vitin 1937. Lazër Çeta ka vdekur në moshën 45-vjeçare, në vitin 1940, nga një traumë aksidentale³⁴.

Kontributi i Lazër Çetës në administratën shtetërore

Lazër Çeta është ndër shqiptarët e rrallë që ka kontribuar në administratën e shtetit shqiptar që kur ky shtet lindi më 28 nëntor 1912 e deri në vitin 1940, kur ky patriot dhe intelektual i shquar ndërroi jetë. Ky personalitet i shquar kontribuoi në administratën e pothuajse të gjithë qeverive, duke filluar nga Qeveria e kryesuar nga Ismail Qemali e deri te qeveria e Zogut, pavarësisht prej rrymave e partive politike prej të cilave formoheshin e rrezoheshin këto qeveri. Në këtë kuptim Lazër Çeta, siç

³³ Gjet.Ndoj, vep. cit. f. 314.

³⁴ Po aty, f. 315.

do ta shohim edhe më poshtë, ishte pjesë profesionaliste e Administratës Shtetërore Shqiptare, si pjesa më substanciale dhe kontinuitive e shtetit të ri shqiptar.

- Në vitet 1913-1918 u emërua dhe shërbeu si sekretar i komandës së xhandarmërisë, përkatësisht i Shkodrës, i Lezhës dhe Gjakovës.

- Sapo u formua qeveria e Lushnjës e kryesuar nga Sulejman Delvina, nga tetori i vitit 1920 e deri në gusht të vitit 1921 (kur selia e Qeverisë ishte transferuar në Tiranë), Lazër Çeta emërohet sekretar i Gjyqit Politik të Tiranës.

- Nga gushti i vitit 1921 e deri në dhjetor të vitit 1923 (më shumë se dy vjet), Lazër Çeta emërohet si sekretar i përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

- Nga 20 dhjetori i vitit 1923 e deri në fund të dhjetorit 1925 Lazër Çeta ka kryer disa detyra pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, si më poshtë:

Më 20 dhjetor 1923 emërohet sekretar i dytë në Drejtorinë administrative-konsullore të MPJ.

Lazër Çeta, nga 24 dhjetori i vitit 1924 e deri më 21 shkurt 1925, punoi në Drejtorinë e Financave. Më 21 shkurt të vitit 1925 dekretohet Sekretar i Legatës Shqiptare në Beograd. Në dhjetor të këtij viti pushohet nga puna për motive politike, pasi siç informohemi Lazër Çeta përkrahte dhe ndihmonte emigrantët antizogistë.

Pas më shumë se 2 vjetësh pa punë, Lazër Çeta ftohet për të kontribuar dhe emërohet më 18 qershor 1928 sekretar i përgjithshëm i Ministrisë Arsimit, derisa hapet Gjimnazi i Shtetit në Tiranë, ku emërohet dhe punon për më shumë se 1 vit profesor.

Më 26 shtator të vitit 1931 dekretohet dhe emërohet shef i Sektorit të bursave pranë Ministrisë së Arsimit, detyrë të cilën e mban deri në shkurt të vitit 1934.

Në shkurt të këtij viti Lazër Çeta emërohet drejtor i arsimit fillor e normal pedagogjik, në Ministrinë e Arsimit. Nga nëntori i vitit 1935 e deri në vitin 1940 Lazër Çeta e ka kryer me sukses detyrën e Sekretarit të Ministrisë së Arsimit³⁵.

Nga sa përshkruam më sipër duket qartë se, në radhë të parë, kontributi i Lazër Çetës, ishte jo vetëm i pandërprerë, që kur lindin institucionet e para të shtetit shqiptar e deri në fillimet e Luftës së Dytë. Ai kontribut ishte jo vetëm cilësor, por edhe shumë i madh dhe i gjithanshëm i tij.

Lazër Çeta kishte dhënë ndihmesë shumë të madhe në ngritjen dhe funksionimin e xhandarmërisë, veçanërisht në Shkodër, Lezhë e Gjakovë në periudhën e sundimit të Austro-Hungarisë gjatë Luftës së Parë Botërore.

³⁵ Po aty. f. 315-316.

Ishte periudha kur në vjeshtë të vitit 1916 Shqipëria ndodhej e pushtuar nga forcat ushtarake të tri fuqive: të Austro-Hungarisë që e mbante pjesën më të madhe të vendit, Shqipërinë Veriore e të Mesme deri në krahun e djathtë të derdhjes së Vjosës. Këtu u vendos vija e frontit me ushtrinë italiane, e cila pasi i dëboi forcat greke nga Shqipëria e Jugut e pushtoj plotësisht Shqipërinë e Jugut. Në anën tjetër forcat ushtarake franceze e pushtuan krahinën e Korçës³⁶.

Për ndryshim nga zona pushtuese bullgare, sundimtarët austro-hungarezë në Kosovë udhëhiqnin një politikë krejt të ndryshme për t'i përfutur masat popullore.

Keqtrajtimet dhe reprezaljet mbi popullin shqiptar që ishin ushtruar nga Serbia gjatë viteve 1912-1915 tani morën fund. Austro-Hungaria filloi që të përfillë të drejtat kombëtare që për atë kohë për shqiptarët kishte vlerë të madhe³⁷. Populli shqiptar ato të drejta i kërkoi shekuj me radhë në lufta kundër pushtuesve të ndryshëm. Në fillim të vitit 1916 u bënë përpjekje për hapjen e shkollave shqipe në Kosovë. Hapja e këtyre shkollave për shqiptarët kishte rëndësi të veçantë historike. Shkollat shqipe në zonën pushtuese austro-hungareze kanë punuar deri në fillim të tetorit 1918, kur Kosova pushtohet sërish nga forcat serbe. Pushteti austro-hungarez lejoi në Kosovë edhe përdorimin e flamurit kombëtar, vetadministrimin lokal, zhvillimin e kulturës kombëtare dhe disa të drejta tjera. Pra, ishte pikërisht kjo periudhë kohore kur shqiptarët filluan të frymonin më lirshëm dhe pikërisht këtë frymim më të lirshëm intelektual i Lazër Çeta u përpoq që ta shfrytëzonte me tërë qenien në dobi të interesave kombëtare shqiptare.

Duhet potencuar se nuk ka pushtues të mirë dhe se secili pushtues i ka qëllimet e veta, pretendimet territoriale dhe eksploative. E tillë ishte edhe Austro-Hungaria, por prej të gjithë pushtuesve kishte qenë pushtuesi më i mirë deri në atë periudhë kohore.

Natyrisht që Lazër Çeta iu gëzua rinjohjes së shtetit shqiptar nga Konferenca e Paqes e Versajës, ndonëse dihej në çfarë kufijsh u njoh shteti shqiptar. Në rrethanat e jashtme dhe të brendshme të krijuara në fillim të vitit 1920 pozitat e Shqipërisë ishin bërë tejet kritike. Shqipëria mbeti si shtet i ndarë pa pjesët më vitale, sepse u morën për bazë argumentet politike, por të paktën u arrit të rifitohej pavarësia e vendit dhe sidomos të mënjanohejshin padrejtësi të reja territoriale që do të ishin tragjedi e dyfishtë për të ardhmen e kombit³⁸.

36 Paskal Milo, Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927, Tiranë, 1992, f. 41-42; Lush Culaj, Komiteti Mbrojtja kombëtare e Kosovës 1918-1924, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1997, f. 9

37 Limon Rushiti, Lëvizja Kaçake në Kosovë 1918-1928, Instituti i Historisë Prishtinë, Prishtinë, 1981, f. 20.

38 Muin Cami, Shqiptarët për problemin e Kosovës në mbarim të Luftës së Parë Botërore në librin: Çështja e Kosovës një problem historik aktual... vep. cit. f. 144; Lush Culaj, Shqipëria dhe problemi kombëtar 1918-1928, vep. cit. f. 78.

Lazër Çeta iu gëzua Qeverisë të dalë nga Kongresi i Lushnjës më 1920 dhe po atë vit u rikthye nga Kosova për të dhënë kontributin për shtetin e ri shqiptar.

Në kuadrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme ndihmoi mjaft dhe për ngritjen dhe funksionimin e sistemit gjyqësor etj. Gjithashtu, është shumë e evidente edhe veprimtaria e tij si diplomat, duke kryer shumë detyra pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme³⁹.

Mirëpo, kontributi kryesor i Lazër Çetës duket se ka qenë në vitet 30 të shek. XX në fushën e arsimit, si në drejtim të përhapjes, por veçanërisht në drejtim të modernizimit të tij. Kuardro të talentuara si Lazër Çeta jo vetëm ndikuan në kooperimin gjithnjë e më shumë me vendet e përparuara evropiane, por gjatë këtij kooperimi ndodhte gjithnjë e më shumë evropianizimi i shtetit shqiptar dhe shkëputja sadopak nga mentaliteti dhe mënyra anadollake e jetesës.

Kishte jetë të pasur intelektuale duke shkruar shumë libra me tematikë shoqërore dhe edukative. Megjithatë, vepra më e spikatur e tij i përket fushës së historisë dhe titullohet “Përmbledhje e Historisë Ushtarake Botërore e Shqip-tare”, e cila u botua në vitin 1931⁴⁰.

Gjatë veprimtarisë së tij, Lazër Çeta është vlerësuar nga institucionet e shtetit shqiptar, nga bashkëkohës dhe intelektualë të ndryshëm. Bie në sy veçanërisht dekorimi i tij nga presidenti francez me medaljen “Officier d’Acade-mie”, dekoratë e akorduar në vitin 1928.

Sërisht në vitin 1934 Lazër Çeta dekorohet për herë të dytë nga shteti francez me medaljen “Kryqi i Kalorësit të Legjionit të Nderit” etj.⁴¹

Anton Çetta

Siç e kemi thënë më përpara, Lazër Çeta u martua në vitin 1917 me Agen nga Gjakova, njohje kjo e bërë në kohën kur Lazri ishte sekretar i Komandës së Xhandarmërisë në Gjakovë. Pas tre vjetësh lindi në këtë qytet djali i parë i Lazër Çetës, Antoni. Ai lindi në Gjakovë më 3 janar 1920. Vetëm pas disa muajsh, Lazër Çeta transferohet në Tiranë duke u emëruar (në kohën kur selia e Qeverisë së Sylejman Delvinës transferohet nga Lushnja në Tiranë) sekretar i Gjyqit Politik (tetor 1920). Në këto kushte fëmijërinë e hershme dhe mësimet e para i mori në Tiranë, tashmë kryeqyteti i shtetit të cunguar shqiptar⁴².

39 Gjet Ndoj, vep. cit. f. 315.

40 Po aty. f. 315-316.

41 Po aty. f. 316.

42 Mr. Nevrije Bislimi - Ismajli, Anton Çetta - mbledhës dhe studiues i folklorit, Rozafa, Prishtinë, 2008, f. 6.

Shkollën e mesme e nisi në Tiranë, e vazhdoi në Liceun Francez të Korçës dhe tre katër vitet e fundit të Liceut - drejtimi klasik - në Milano të Italisë⁴³. Për një kohë të shkurtër punësohet në "Posttelegraf" të Tiranës⁴⁴.

Me dhimbje në zemër dhe mall për Kosovën, Anton Çeta do të qëndrojë në Shqipërinë politike gjer në vitin 1941. Kthimi i mëhershëm ishte i pamundur, sepse patriotizmi i tij dhe i familjes së tij nuk kishte si të mos ngjallte urrejtjen tek okupatori serb. Gjatë qëndrimit në Shqipëri vazhdimisht fliste me të atin e tij rreth mundësisë së çlirimit të Kosovës dhe rikthimit atje. E ardhmja e vërtetoi qëndrimin e Anton Çetës, ngase vërtet u kthye në Kosovë në vitin 1941, në periudhën e sundimit italian. Shqiptarët nacionalistë, ata që shpëtimin e kombit e kanë mbështetur mbi të vërteta parimore të padiskutueshme mbi bashkimin e gjithë shqiptarëve në një shtet të vetëm, nuk gëzoheshin se Kosova ndërroi dorë, se shpëtoi nga thonjtë e serbëve e ra në dorë të italianëve, por se me shpartallimin e veprimeve të padrejta u krye hapi themelor për përmbushjen e ëndrrës shekullore, u bë bashkimi kombëtar, në saje të të cilit edhe fati më i keq do të përballohej ashtu siç i përket popullit të bashkuar në përpjekje të përbashkëta.

Këtë mendim e ndante me shqiptarët nacionalistë edhe Anton Çeta. Pra, një vit pas vdekjes të atit, Lazrit, ndërsa nëna e tij Ageja e kishte lënë vite më parë, Antoni bashkë me motrën e tij, largohen përgjithmonë nga Shqipëria, për t'u vendosur te dajat në Kosovë. Ndërkaq, vëllai i vogël, Beniamini, me nënën tjetër (Katrinen nga Durrësi) largohen edhe këta nga Tirana për në Durrës.

I pajisur me dije në Prizren, Tiranë, Korçë dhe Milano, në vitin 1945 Anton Çeta me hapa të sigurt nis karrierën e tij pedagogjike si profesor në Gjinnazin e Prizrenit, për të regjistruar një vit më vonë studimet në Grupin e Romanistikës - Dega e Gjuhës Frënge, në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Beogradit, të cilat i mbaroi në afatin rekord brenda katër vitesh. Meqë ishte shquar në studime, pas diplomimit, pedagogët e tij e emërojnë asistent në Seminarin e Gjuhës Shqipe të Fakultetit Filologjik të Beogradit, ku punoi rreth dhjetë vjet⁴⁵.

Anton Çeta ishte studiues i kulturës popullore, por dhe i kulturës sonë kombëtare në përgjithësi.

Anton Çeta, i biri i Lazër Çetës, është njëri ndër intelektualët, etnografët dhe folkloristët më të shquar të kohës tonë.

Kontributin më të madh si intelektual ai e dha kur ishte profesor në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës dhe punonjës shkencor i Institutit Albanologjik të Prishtinës.

43 Po aty.

44 Po aty.

45 Po aty, f. 7.

Në vitin 1961 nga Beogradi kthehet në Prishtinë dhe emërohet ligjërues në Degën e Gjuhës Shqipe të Fakultetit Filozofik, ku ligjëroi mbi shtatë vjet Letërsinë e Rilindjes dhe Letërsinë e vjetër shqipe. Njohuritë e tij të thella klasike dhe moderne për letërsinë dhe gjuhën bënë që prof. Anton Çeta në Fakultetin Filozofik të krijojë emër si njëri ndër profesorët më me autoritet të kohës.

Profesor Çeta, që në fillet e organizimit të arsimit shqip, në vitet 50 merret edhe me hartimin dhe përpilimin e teksteve shkollore për letërsi dhe gjuhë shqipe si dhe të doracakëve të ndryshëm si koautor me Idriz Ajetin, Gani Lubotenin, Mark Krasniqin, Rexhep Hoxhën etj.⁴⁶

Karrierën shumëvjeçare të nisur në Prizren, të vazhduar në Fakultetin Filologjik të Beogradit dhe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, nga viti 1967 e vazhdoi në Institutin Albanologjik të Prishtinës, ku kaloi si studiues në Degën e Folklorit. Tani e tutje me tërë qenien e tij intelektuale ai do t'i përkushtohet krijimtarisë folklorike, mbledhjes, botimit dhe studimit të saj. Në Institut, si përgjegjës kryesor i Degës së Folklorit, profesor Çeta përgatit strategjinë dhe projektin e madh të regjistrimit të krijimtarisë gojore. Fillimisht në mungesë të kuadrove të brendshme për gjurmime në terren, mbledhjen e lëndës folklorike në të gjitha trevat shqiptare në ish-Jugosllavi e nis me bashkëpunëtorët e jashtëm, të cilët kryesisht ishin studentë, mësues dhe arsimtarë. Anton Çeta ishte jo vetëm organizatori kryesor i kësaj pune kolosale, por edhe mësues i kuadrove për folklor. Pjesën më të rëndësishme të këtyre materialeve folklorike arriti t'i botonte Instituti Albanologjik, kurse një pjesë e konsiderueshme e materialeve të pabotuara gjendet në Arkivin e Institutit Albanologjik të Prishtinës, themelues i të cilit ishte ai vetë.

Krahas materialit folklorik, ai na la në trashëgim edhe një lëndë të pasur etnografike nga fusha e pleqnive, apo tregimeve juridike popullore (pleqnive), dromcave dhe tregimeve etnografike etj.

Një tjetër punë e rëndësishme e prof. Anton Çetës, që është rezultat i njohjes së traditave, dokeve, zakoneve, kodit kanunor dhe krijimtarisë folklorike, është pajtimi i gjaqeve, ngatërresave dhe hasmërive në popull. Në moshë të shtyrë, duke e njohur në thelb shpirtin e popullit, ai e nisi këtë mision sa human, po aq të rëndësishëm për momentin historik në të cilin ndodheshin shqiptarët në ish-Jugosllavi. Duke pasur njohuri mbi kuvendet e mëparshme historike për ta falur njëri-tjetrin si parakusht i pajtimit dhe bashkimit kombëtar për kundërvënien e suksesshme ndaj okupatorit, së bashku me intelektualë të tjerë i prinë këtij misioni që paralajmëronte

46 Libër leximi për klasën V të shkollës fillore, Prishtinë 1954; Libër leximi për klasën III-IV të gjimnazit dhe të shkollave të mesme profesionale, "Rilindja", Prishtinë, Prishtinë, 1959; Libër leximi për klasën III-IV të gjimnazit dhe shkollave të mesme profesionale, Beograd, 1962; Mr. Nevrije Bislimi- Ismajli, Anton Çeta mbledhës dhe studiues i folklorit, vep. cit., f. 7.

fitoren dhe lirinë tonë të afërt. Me ndihmën e qytetareve shqiptarë ai arriti të organizonte tubime të mëdha që në atë periudhë kohore konsideroheshin format më të suksesshme të manifestimit të pakënaqësisë me gjendjen e rëndë okupuese⁴⁷.

Prof.dr. Lush CULAJ

SUMMARY

THE HISTORICAL GENESIS OF ANTON ÇETA'S FAMILY

Grandfather of Anton Çeta

Mark Çeta undoubtedly was among notorious men of this patriotic family. He was born on 1860, in village Xhuxhe of Fan. 24 year old, Mark left its birthplace and moved to Prizren in 1884, working as adjutant of the Austrian consul in town. Not long after, he marries there Gjyste, a daughter of famous family in Prizren. They had five children from the marriage, two boys and three girls. Elder son was Kola, and second was Lazri (father of Anton Çeta).

In period between 1884 and 1898, Mark was actively involved with Austrians, in particular for issues related with interests of the Albanian national movement. Soon he established contacts to leaders of Movement for National Liberation.

After 1898, Mark Çeta was transferred from Austria-Hungary consulate in Prizren to consulate of Thessaloniki. He used his five year stay there to educate both sons Kola and Lazri in the French Lyceum until 1903.

Mark Çeta has been actively involved in uprisings 1910 – 1912 which preceded the Independence of Kosova in fierce fighting against the Ottoman Empire and expansive neighbors. His actions of the time were focused on active organization of 1910 uprising in Kosova.

Mark was part of Albanian government forces against revolt of anti-Albanian, Sultan supporter led by Haxhi Qamili in 1914. He also fought against forces of Esad Pasha. Mark Çeta participated on resistance against Montenegrin invasion of Shkodra. He died in Tirana from a severe illness on October 13, 1928.

Lazër Çeta, father of Anton was born in Mirdita on February 1, 1895.

⁴⁷ Po. aty. f. 12.

Beniamin the son of Lazer, who lives in Durres owns a copy of his passport that contains such data. He finished 5-year Elementary education in Prizren in 1908. Lazer began Secondary education in Skopje (low Gymnasium) and later finished it in Thessaloniki in 1912.

Contribution of Lazër Çeta in the state administration

Lazer Çeta is one of the few Albanians who contributed to the Albanian State administration since its foundation on November 28, 1912 until 1940, when this prominent intellectual and patriot died. He contributed in the administration of all governments, from the first cabinet headed by Ismail Qemali to King Zog's government, regardless of political affiliations which formed and failed these. In this sense Lazer Çeta was part of the State Administration professionals as most substantial and continuative member of the new Albanian State.